

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË

“N3H” Sh.p.k.

Sot, më datë 14/12/2021, personat e mëposhtëm:

1. Z. Aldo Muça, shtetas shqiptar, i biri i Skënderit, lindur më 18/10/1980 në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit (kartë identiteti) me nr. 035360384 dhe nr. Personal I01018151F, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar) dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, vendosi të themelojë Shoqërinë Tregtare të emërtuar “N3H” Sh.p.k.

Neni 1

Themelimi, Emri dhe Forma

Emri dhe emërtimi tregtar i Shoqërisë është “N3H” Sh.p.k.
Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar që mbahet nga Qendra Kombëtare e Biznesit (më pas referuar si “QKB”).
Shoqëria do të organizohet si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.P.K.).

Neni 2

Selia

Shoqëria do të ketë selinë e saj në adresën e mëposhtme:

“Bulevardi Dëshmorët e Kombit”, Kulla binjake nr 2, Kati 12, Zyra A2, Tiranë.

Neni 3

Objekti

Shoqëria ka për objekt kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprim apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar.

Më konkretisht por pa u kufizuar në to, shoqëria ka për objekt:

- **Transportin e madhrave të çdo lloji si ne Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, edhe për llogari të të tretëve.**

- Tregtim me shumicë e pakicë import eksport në tërësi të mallrave industriale, ushqimore, e pajisjeve teknologjike, pajisjeve elektronike, elektrike, materiale ndërtimi, hidrosanitare;
- Tregtim i paisjeve dhe artikujve mjekësore, produkteve farmaceutike dhe sistemeve përkatës të menaxhimit që lidhen me to, paisje për laboratore, produkte kimike dhe shërbimeve që lejohen nga legjislacioni shqiptar në fuqi;
- Prodhim dhe tregtim gazi teknik, terapeutik, farmaceutik, ushqimor dhe gazrave të tjerë në përgjithësi;
- Projektimin realizimin dhe instalimin e impianteve të lidhura me gazin përfshirë këtu dhe projektimin, realizimin e instalimin e impjanteve elektrike të domosdoshme për funksionime tyre;
- ndërtime civile, impiante hidraulike, mekanike dhe elektrike për strukturat spitalore, ndërtime ujësjellsash dhe kanalizimesh, rikonstruktiv i ndërtesave civile dhe spitalore, gjermime, sisteme, mbushje të terreneve, centrale hidroelektrike;
- Dizenjim software-i. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software. Testim software. Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit. Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë. Zhvillim sistemesh migrimi;
- Tregtim mjete motorike, detare, etj;

Neni 4

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar. Shoqëria mund të priset në cdo kohë me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 5

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 lekë (Njëqind mijë lekë). Kapitali themeltar përbëhet nga 1 (një) kuotë me pjesëmarrje në përfaqësi 100 (njëqind), dhe është paguar e zotërohet tërësisht nga ortaku i vetëm i shoqërisë, përkatësisht 100%, **Z. Aldo Muça**.

Neni 6

Organet e Shoqërisë

Drejtimi i Shoqërisë kryhet nëpërmjet organeve të shoqërisë, të cilat janë:

- a. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
- b. Administratori.

Organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë rregullohet nga Statuti.



Neni 7

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

Asambleja e Përgjithshme do të jetë organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

Neni 8

Administratori

Organi Administrues përbëhet nga 1 (një) Administrator që emërohet e shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ri-emërimi.

Z. Aldo Muça, shtetas shqiptar, , i biri i Skënderit, lindur më 18/10/1980 në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit (kartë identiteti) me nr. 035360384 dhe nr. Personal I01018151F, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, caktohet Administrator i parë i shoqërisë me mandat 5 vjecar, nga data e themelimit të Shoqërisë.

Neni 9

Te dhëna vullnetare per QKB

Shoqëria do të ketë si e-mail: infon3h@gmail.com

Numrer kontakti: 0672069883

Neni 10

Dispozita Përfundimtare

Për të gjitha çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Akt Themelimi, do të zbatohen parashikimet e Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (të ndryshuar).

Ky Akt Themelimi nënshkruhet rregullisht në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

Për regjistrimin e Aktit të Themelemit dhe Statutit të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit autorizohet **Z. Gerti Idrizi**, me karte identiteti me nr 037291835 i cili mund të kryejë cdo veprim në lidhje me regjistrimin e Shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES

Z. Aldo Muça

ALDO MUÇA
